

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“THAMER GENERAL TRADING” SH.P.K**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**THAMER GENERAL TRADING**” Sh.p.k.

- 1- THAMER ALI RADHI ZAIDAWI**, atesia **ALI**, shtetas irakian, lindur me 25.03.1976 ne IRAK , identifikohet nepermjet pasaportes Nr. A11178300.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjisacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themeli të shoqërisë “**THAMER GENERAL TRADING**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “**THAMER GENERAL TRADING** ” Sh.p.k

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjisacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “GLAUKIA” Lagja 17,Brenda Ambienteve te Tregut Industrial, Durres, Shqiperi.Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 **KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5 **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria “**THAMER GENERAL TRADING**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të :

5.1 Tregeti te mallrave dhe produkteve te ndryshem, Import –Export te produkteve te ndryshme, shitje me shumice dhe pakice te produkteve te ndryshme.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind Mije Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- THAMER ALI RADHI ZAIDAWI	100,00 %
-----------------------------	----------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.


NENI 7 **AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 **ORGANET DREJTUESE**

2

AKT THEMELIMI “**THAMER GENERAL TRADING**” SHPK



Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**THAMER GENERAL TRADING**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar Eduart Memia.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje apo konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 16.03.2018

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“THAMER GENERAL TRADING” SH.P.K.**

THAMER ALI RADHI ZAIDAWI

